

L I G J
Nr.7743, datë 26.7.1993

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7582, DATË 13.7.1992 "PËR NDERMARRJET
SHTETËRORE"**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr. 7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", në kreun IV, para nenit 32 shtohet neni 31/a me këtë përmbajtje:

"Personat përgjegjës në ndërmarrjet shtetërore, për kryerjen e pagesave me lekë në dorë mbi limitin ditor të arkës të caktuar nga Këshilli i Ministrave, dënohen për kundërvajtje administrative me gjobë deri në 5 mijë lekë. Të drejtën e gjobës e kanë punonjësit e seksionit të financës të rrethit dhe bashkisë për Tiranën".

Kundër vendimit të dënimit me gjobë të dhënë nga punonjësit e seksionit të financës të rrethit dhe të bashkisë për Tiranën ankimi bëhet në përputhje me procedurën e caktuar nga ligji nr.7697 datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.623, datë 4.8.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.